



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

PROGRAMI: MENAXHIM BIZNESI (MSc.)

Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit:	Menaxhim Biznesi
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	ISCED 7
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi Specializimet: 1. Menaxhim Biznesi 2. Banka dhe Financa
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC):	04 (04.0, 04.3) Program interdisiplinar studimi
Kohëzgjatja minimale e studimit:	2 vite, 4 semestra
Forma e studimit:	Studime të rregullta
Numri i ECTS kredive:	Gjithsej 120 ECTS, për një vit 60 ECTS
Profili i programit akademik (specializimi):	1. Menaxhim Biznesi në gjuhën shqipe dhe boshnjake 2. Banka dhe Financa në gjuhën shqipe dhe boshnjake
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Programi Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi është konceptuar në përputhje të plotë me misionin e Universitetit "Haxhi Zeka", duke integruar standardet bashkëkohore akademike, kërkimore dhe profesionale në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë. Qëllimi kryesor i këtij programi është zhvillimi i profesionistëve të aftë, me kompetenca të larta menaxheriale, analitike dhe kërkimore, të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të rajonit dhe të vendit përmes zbatimit të njohurive shkencore në praktikën e biznesit modern. Programi është ndërtuar mbi parimet e transferimit të dijes, mendimit kritik, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit, duke synuar që çdo student të realizojë potencialin e tij akademik dhe profesional në një mjedis dinamik të tregut të punës. Përmes përfshirjes së kërkimit shkencor, aplikimeve praktike dhe zhvillimit të kompetencave ndërdisiplinare, programi fuqizon studentët të analizojnë, menaxhojnë dhe transformojnë proceset e biznesit në nivel mikro dhe makroekonomik.

I. Qëllimet kryesore të programit janë:

- Të ofrojë arsimim të avancuar shkencor dhe profesional në fushën e menaxhimit të biznesit dhe financave, duke zhvilluar aftësi analitike, kritike dhe krijuese tek studentët;
- Të përgatisë liderë të ardhshëm, menaxherë dhe ekspertë që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të organizatave publike dhe private;
- Të nxisë kërkimin shkencor dhe aplikativ, duke orientuar studentët drejt analizës së problematikave reale të tregut dhe krijimit të zgjidhjeve inovative;
- Të forcojë lidhjen ndërmjet teorisë dhe praktikës përmes përfshirjes së praktikave profesionale, bashkëpunimit me industrinë dhe studimeve të rasteve konkrete;
- Të zhvillojë kompetenca ndërkombëtare, aftësi komunikimi ndërkulturore dhe fleksibilitet profesional për tregun global të punës;
- Të promovojë mësimin gjatë gjithë jetës, sipas standardeve të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

II. Qasja e orientuar drejt studentit

- Në përputhje me filozofinë e Fakultetit të Biznesit, ky program e vendos studentin në qendër të procesit mësimor.
- Studenti konsiderohet partner aktiv në procesin akademik, jo vetëm përfitues i dijes.
- Ai është personi më i rëndësishëm në institucion, burimi kryesor i zhvillimit të tij dhe arsyeja e ekzistencës së çdo procesi universitar.
- Për këtë arsye, të gjitha aktivitetet mësimore, kërkimore dhe bashkëpunuese janë të orientuara drejt rritjes së përvojës studentore, cilësisë së të nxënësve dhe përgatitjes për tregun e punës.

III. Objektivat specifike të programit

Pas përfundimit të studimeve, studentët do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë njohuritë e avancuara në fushën e menaxhimit, financave dhe analizës së biznesit;
- Hartojnë strategji zhvillimore dhe zgjidhje efektive për problemet menaxheriale dhe ekonomike;
- Përdorin metoda cilësore dhe sasiore në kërkimin shkencor dhe aplikativ;
- Tregojnë kompetencë të lartë profesionale, etike dhe udhëheqëse në mjedisin organizativ;
- Përshtaten me ndryshimet dinamike të tregut të punës dhe zhvillimeve teknologjike;
- Ndërmarrin nisma të reja në fushën e biznesit, inovacionit dhe sipërmarrjes;

	– Kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe institucional të vendit.
Rezultatet e pritshme të të nxënit:	Rezultatet e të nxënit për programin Menaxhim Biznesi janë unike dhe të përshtatura për të adresuar në mënyrë të plotë nevojat e dy specializimeve: Menaxhim Biznesi dhe Banka dhe Financa. Ky program siguron një balancë të qëndrueshme midis njohurive teorike të avancuara dhe aftësive praktike të zbatueshme, duke përfshirë zotërimin e njohurive mbi teoritë bashkëkohore të menaxhimit, bankave dhe financave (NJ3) dhe përdorimin e ekonomiksit menaxherial për të adresuar vendime strategjike komplekse (A-C2). Për më tepër, rezultatet e të nxënit, si analiza kritike e mjediseve të biznesit dhe përshtatja e strategjive për sukses global (NJ2) apo aftësia për të kryer kërkime të avancuara me metoda cilësore dhe sasiore (A-C1), janë të dizajnuara për të plotësuar kërkesat e dy fushave. Të dy specializimet përfitojnë nga një përqendrim i veçantë në zbatimin e teorive organizative për zhvillimin e strategjive efektive të menaxhimit (A-C3), si dhe në përdorimin e sistemeve të informacionit dhe analizave të të dhënave (A-C5), duke u përshtatur përkatësisht me nevojat unike të secilit drejtim. Kjo qasje gjithëpërfshirëse garanton që të gjitha rezultatet e pritshme të programit janë të integruara në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme brenda lëndëve dhe syllabuseve të të dy specializimeve. Kjo jo vetëm që rrit kompetencat akademike dhe profesionale të studentëve, por edhe siguron një përshtatje të plotë me misionin e programit dhe nevojat e tregut. Prandaj, rezultatet e synuara të të nxënit të programit janë dizajnuar duke u bazuar në "përshkrimet e Dublinit" dhe janë të përqendruara tek studenti duke theksuar rëndësinë e njohurive, aplikim- kompetenca dhe të aftësive që do të zhvillojë gjatë studimeve Rezultatet e të nxënit për programin Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi: Njohuritë (NJ) *NJ1. Zotëron dhe aplikon njohuri të avancuara mbi parimet etike dhe adreson dilemat komplekse profesionale NJ2. Analizon dhe në menyrë kritike vlerëson mjediset e biznesit dhe përshtat strategjitë për suksesin global NJ3. Njohuri të avancuara mbi teoritë bashkëkohore në fushën e menaxhimit të biznesit, bankave dhe financave Aplikim- Kompetenca (A-K) **A-K1. Kryen kërkime të avancuara duke përdorë metoda cilësore dhe sasiore për të adresuar dhe zgjidhur problemet e biznesit dhe financave A-K2. Aplikon ekonomiksin menaxherial për të analizuar dhe adresuar çështje komplekse të biznesit dhe për të marrë vendime

	strategjike A-K3. Zbaton dhe vlerëson në mënyrë kritike teoritë organizative për të zhvilluar strategji efektive të menaxhimit A-K4. Drejton projekte sipërmarrëse dhe inovative duke përdorë parimet e menaxhimit strategjik dhe financiar A-K5. Përdor sistemet e informacionit të menaxhimit dhe analiza efektive të të dhënave mbi operacionet e biznesit Aftësitë (A) ***A1. Aftësi për të prezantuar informacione komplekse, argumentuese dhe bindëse A2. Bashkëpunon efektivisht në punë ekipore dhe demonstroi aftësi të avancuara udhëheqëse dhe menaxheriale Rezultatet e pritura janë në përputhje të plotë sipas standardit 4.7, treguesi 4.7.1 të Manualit të AKA-së.
Procedurat e mësimdhënies:	I. Procesi Mësimor dhe Metodologjia e Mësimdhënies Procesi mësimor zhvillohet përmes ligjëratave interaktive, ushtrimeve praktike dhe sesioneve laboratorike, të organizuara në kabinete të specializuara të teknologjisë, ekonometrisë dhe laboratorë financiarë bashkëkohore. Kjo qasje synon të integrojë në mënyrë të balancuar teorinë dhe praktikën, duke ndërtuar te studentët një bazë të fortë akademike dhe njëkohësisht aftësi të zbatueshme profesionale. Çdo lëndë përfshin komponentë kërkimore, projekte individuale dhe grupe, si dhe vlerësime të vazhdueshme të përcaktuara qartë në syllabusin përkatës, gjatë të dy semestreve akademikë. Raporti ndërmjet përmbajtjes teorike dhe asaj praktike është i përcaktuar në 50:50, ndërsa në varësi të natyrës së lëndës dhe kërkesave akademike, mund të variojë deri në 60:40 në favor të pjesës teorike-praktike. Studentët kanë mundësinë të aplikojnë njohuritë e tyre në situata reale përmes lëndës "Praktika dhe Zhvillimi i Karrierës", e cila është obligative. Në këtë kuadër, ata realizojnë praktika profesionale në institucione publike dhe private, në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën për Zhvillimin e Karrierës (UHZ), e cila siguron mbështetjen e plotë për përzgjedhjen dhe organizimin e vendeve të praktikës. II. Metodot e Mësimdhënies Mësimdhënia bazohet në një metodologji bashkëkohore, interaktive dhe të orientuar drejt rezultateve, e cila synon zhvillimin e aftësive analitike, kërkimore, menaxheriale dhe vendimmarrëse të studentëve. Kjo qasje përfshin një kombinim të metodave tradicionale akademike me praktikën më të mira ndërkombëtare në arsim dhe biznes. Metodat e përdorura përfshijnë:

	– Ligjërata interaktive dhe prezantime profesionale në <i>PowerPoint</i> dhe platforma digjitale të avancuara, të harmonizuara me syllabusin e çdo lënde; – Analiza të rasteve studimore nga praktika e bizneseve vendore dhe ndërkombëtare; – Diskutime të hapura dhe punë në grupe, për nxitjen e mendimit kritik, kreativitetit dhe komunikimit efektiv ndërmjet studentëve dhe pedagogëve; – Ushtrime aplikative me shembuj konkretë nga fusha të ndryshme të ekonomisë, financave, kontabilitetit, auditimit, menaxhimit, marketingut, bankave, ndërmarrësisë etj.; – Projekte kërkimore dhe praktike, të cilat prezantohen dhe diskutohen në mënyrë bashkëpunuese, në një ambient dinamik, inovativ dhe profesional të të nxënit. III. Zbatimi i Metodologjisë në Procesin Mësimor Pas çdo ore mësimore, studentëve u jepen detyra për zgjidhje dhe reflektim, të cilat diskutohen gjatë javës në vijim, si në orët e ligjëratës, ashtu edhe në ato të ushtrimeve. Qëllimi është të inkurajohet pjesëmarrja aktive dhe të zhvillohen kompetencat e nevojshme për t'i përgatitur studentët si profesionistë të aftë, analitikë dhe të adaptueshëm në tregun vendor, rajonal, dhe global të punës. Mbajtja e ligjëratave dhe ushtrimeve realizohet në formatin e mëposhtëm: – Prezantimi i temës përmes <i>PowerPoint</i> dhe zgjidhja e detyrave në tabelë, në laboratorë financiar, të ekonometrisë përmes sftowereve të avancuar varësisht nga qëllimet e lëndëve; – Analiza e rasteve studimore, të lidhura ngushtë me temën e ligjëratës; – Përsëritja e temave nga studentët për të forcuar të nxënit aktiv; – Aplikimi praktik i programeve profesionale; – Diskutime dhe analiza nga ekspertë të ftuar të fushës, në nivel vendor dhe ndërkombëtar; – Përgatitja e raporteve financiare, analizave studimore dhe hulumtimeve të lidhura me industrinë. – Secili rezyulta ti prituri i lëndëve është i lidhur ngushtë me rezultatet e pritura të programit.
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve);	Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ dhe rregullorës për studime Master, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë. Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimmshënësi i lëndës. Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve,

	projekteve shkencore, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. Gjithashtu vlen të theksohet se rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A) Metodat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, Një shembull vlerësimi është si më poshtë: <table data-bbox="743 613 1383 772"> <tr> <td>Projekt shkencor:</td><td>20%</td></tr> <tr> <td>Ushtrime:</td><td>20%</td></tr> <tr> <td>Interaktivitet, pjesëmarrje dhe obligime tjera:</td><td>10%</td></tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar:</td><td>50%</td></tr> <tr> <td>Total</td><td>100%</td></tr> </table> Gjersa, një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: <table data-bbox="743 814 1140 1033"> <tr> <td>0-50.99%</td><td>(5)</td></tr> <tr> <td>51-60.99%</td><td>(6)</td></tr> <tr> <td>61-70.99%</td><td>(7)</td></tr> <tr> <td>71-80.99%</td><td>(8)</td></tr> <tr> <td>81-90.99%</td><td>(9)</td></tr> <tr> <td>91-100%</td><td>(10)</td></tr> </table>	Projekt shkencor:	20%	Ushtrime:	20%	Interaktivitet, pjesëmarrje dhe obligime tjera:	10%	Provimi përfundimtar:	50%	Total	100%	0-50.99%	(5)	51-60.99%	(6)	61-70.99%	(7)	71-80.99%	(8)	81-90.99%	(9)	91-100%	(10)
Projekt shkencor:	20%																						
Ushtrime:	20%																						
Interaktivitet, pjesëmarrje dhe obligime tjera:	10%																						
Provimi përfundimtar:	50%																						
Total	100%																						
0-50.99%	(5)																						
51-60.99%	(6)																						
61-70.99%	(7)																						
71-80.99%	(8)																						
81-90.99%	(9)																						
91-100%	(10)																						
Modulet /Lëndët (titujt):	<u>Vitet, Semestrat, Lëndët</u> <u>Viti I</u> <u>Semestri I</u> 1. Metodat Cilësore në Kërkim Shkencor (O) 2. Ekonomiksi i Avancuar Menaxherial (O) 3. Teoritë Bashkëkohore të Organizimit (O) 4. Menaxhmenti Financiar i Avancuar (O) 5. Menaxhimi i PPP-ve (Z) 6. Menaxhimi i Kapitalit të Bankës dhe Sigurimeve (Z) 7. Auditimi i Avancuar (Z) <u>Viti I</u> <u>Semestri II</u> 1. Metodat dhe Teknikat Sasiore në Kërkim Shkencor (O) 2. Menaxhimi Strategjik i Avancuar (O) 3. Sistemet e Informacionit të Menaxhimit (O) 4. Mjedis Biznesor Ndërkombëtar (O) 5. Menaxhimi Total i Cilësisë (Z) 6. Ekonometria Financiare (Z) 7. Kontabiliteti Financiar i Avancuar (Z) 8. Kontabiliteti i Kostos (Z) 9. Ndermarresia e Gjelbër (Z)																						

	<u>Viti II</u> <u>Semestri III</u> Specializim në Menaxhim Biznesi 1. Ndërmarrësia dhe Inovacionet (O) 2. Menaxhimi i Projekteve të BE-së (O) 3. Mësimi Praktik dhe Zhvillimi i Karrierës (O) 4. Lidershipi dhe Vendimmarrja (O) Specializim në Banka dhe Financa 1. Menaxhimi i Institucioneve Financiare (O) 2. Financat e Avancuara të Korporatave (O) 3. Investimet dhe Menaxhimi i Portofolit (O) 4. Mësimi Praktik dhe Zhvillimi i Karrierës (O) Lëndët zgjedhore për të dy specializimet: 1. Bashkimi dhe Blerjet e Bizneseve (Z) 2. Menaxhimi i Marketingut (Z) 3. Etika në Biznes (Z) 4. Sjellja Konsumatore (Z) 5. Analiza e të Dhënave me ERP (Z) 6. Menaxhimi i Stresit dhe Kohës (Z) 7. Qeverisja Mjedisore, Sociale dhe Korporative (Z) 8. Tregjet dhe Financat Ndërkombëtare (Z) 9. Financat Digjitale (Z) 10. Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimet (Z) 11. Politika Monetare (Z) 12. Vlerësimi i Rrezikut dhe Kontrolli në Korporata (Z) 13. Auditimi i Performances (Z) <u>Viti II</u> <u>Semestri IV</u> Punimi i Masterit (O)
Numri i vendeve të studimit:	120 (100 në gjuhë shqipe, 20 në gjuhë boshnjakë)
Udhëheqës i drejtimit/programit të studimit:	Prof. Ass. Dr. Enkeleda Lulaj Prof. Ass. Dr. Bashkim Nurboja Prof. Ass. Dr. Emin Neziraj
Personeli i përhershëm shkencor/artistik: (Numri sipas kategorive të personelit)	7 profesorë të rregullt, 10 profesorë të asocuar, 10 profesorë asistent, 4 asistentë një më thirrje Dr. Sc.
Taksat e studimit:	Të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Studimet janë falas. Vërejtje: Në rast kur përsëritet viti, bëhet pagesa sipas Udhëzimit

	Administrativ MASHTI Nr.09/2021.
Mundësitë e punësimit pas diplomimit:	Programi Master i Shkencave në Menaxhim Biznesi përgatit profesionistë të aftë për tregun dinamik të punës, duke i pajisur me njohuri të avancuara teorike, analitike dhe praktike në fushat e menaxhimit, financave, kontabilitetit, ndërmarrësisë, ekonomisë digjitale dhe lidhësive strategjike. Falë strukturës moderne të kurrikulës, orientimit praktik dhe bashkëpunimit të ngushtë me industrinë, të diplomuarit e këtij programi gëzojnë mundësi të gjera punësimi në sektorin publik, privat dhe ndërkombëtar, si dhe potencial të lartë për vetëpunësim dhe zhvillim profesional. 1. Sektori Privat dhe Korporatat – Kontabilist, financier apo analist ekonomik; – Analist performance, kontrollor i brendshëm, auditor, apo menaxher i cilësisë; – Menaxher apo asistent menaxher në kompani vendore dhe ndërkombëtare; – Specialist në marketing, shitje, komunikim apo marrëdhënie me klientët; – Koordinator projekte, burimesh njerëzore (HR) ose operimesh; – Konsulent për menaxhim strategjik, zhvillim organizativ dhe digjitalizim biznesi. 2. Sipërmarrje dhe Start-up – Themelues dhe drejtues i bizneseve të reja (start-up apo SME); – Menaxher zhvillimi biznesi, produkti apo inovacioni; – Konsulent për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje biznesi; – Drejtues i iniciativave në ndërmarrësi të gjelbër dhe inovacion social. 3. Institucionet Bankare dhe Financiare – Specialist kredish, risku apo shërbimesh klienti; – Analist financiar, kontabilist i avancuar apo këshilltar investimesh; – Menaxher portofoli apo këshilltar për produkte bankare; – Ekspert në sigurime, financa digjitale dhe menaxhim kapitali. 4. Sektori Publik dhe Organizatat Ndërkombëtare – Specialist apo zyrtar administrativ në institucione publike; – Koordinator projekte zhvillimore dhe ekonomike; – Ekspert i politikave të biznesit, investimeve dhe zhvillimit; – Konsulent në fushën e menaxhimit publik dhe qeverisjes ekonomike; – Punonjës në agjenci qeveritare, komuna apo institucione ndërkombëtare. 5. Konsulencë, Analizë Biznesi dhe Teknologji

- Konsulent biznesi, strategjie apo zhvillimi organizativ;
- Analist të dhënash, tregu dhe performancës;
- Konsulent financiar apo i menaxhimit të kostove;
- Specialist për transformim digjital dhe zbatimin e ERP sistemeve.

6. Arsimi dhe Kërkimi Shkencor

- Asistent mësimdhënieje apo kërkimi në universitete;
- Administrator akademik apo koordinator programi studimi;
- Mësues i lëndëve ekonomike në arsimin e mesëm (pas trajnimeve shtesë);
- Ekspert kërkimi dhe analize në institute ekonomike e zhvillimore.

7. Institucione dhe Organizata të tjera Biznesore

- Punonjës apo koordinator në Oda Ekonomike, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë;
- Ekspert apo këshilltar në agjenci zhvillimore lokale dhe kombëtare;
- Konsulent në organizata joqeveritare (OJQ);
- Punonjës në inkubatorë biznesi, qendra inovacioni dhe projekte ndërkombëtare;
- Përfaqësues biznesi në organizata financiare dhe investuese;
- Asistent kërkimi apo ekspert analitik në institucione ekonomike e financiare.

8. Bashkëpunimet Institucionale dhe Mbështetja për Punësim

Universitetit "Haxhi Zeka" dhe Fakulteti i Biznesit kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani private, institucione publike, banka, dhe organizata tjera që mundësojnë zhvillimin e praktikës profesionale dhe punësim pas diplomimit. Përmes Qendrës për Zhvillimin e Karrierës, fakulteti qëndron në kontakt të vazhdueshëm me tregun e punës, realizon anketa periodike me industrinë përmes Zyrës së Cilësisë, mban takime me Bordin Industrial dhe përshtat përmbajtjen e programit në përputhje me nevojat reale të tregut duke u bayuar gjithashtu në sugjerime të AKA-së dhe të ekspertëve ndërkombëtar të këtij programi.

Kjo qasje garanton që të diplomuarit nga ky program të jenë konkurrues, të përgatitur profesionalisht dhe të kërkuar në tregun vendor, rajonal, dhe ndërkombëtar të punës.